





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Data/Date:	19.09.2024
Nga/Od/From	Baki Beqiri
Për/Za/To:	Fadil Nura, kryetar i Komunës
CC	Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Adelina Spahiu
Tema/Subjekat/Subject	Raporti i takimit për planifikimin e buxhetit – Turiqevc

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Me datë 13.08.2024 është hartuar dhe publikuar në web-faqen e komunës, orari i dëgjime dhe takimeve me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2025, linku » [KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 \(rks-gov.net\)](#)

Takimi në Klinikë të Epërme

Takimi publik u hap më 22.08.2024, ora 13:30 qytetarët u njoftuan nga drejtori i financave rreth qarkoreve bixhetore dhe kërkoi qqë të i japin mendimet dhe kërkesat e tyre të cilat do të inkoorprohen në buxhetin final.

Ljmi » [Dëgjimi i tretë buxhetor është mbajtur në Turiqec. \(rks-gov.net\)](#)

Në Platformën e Konsultimeve Publike: » [KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 \(rks-gov.net\)](#)

KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË

Më datë: 22.08.2024 mbahet konsultimi publik në Klinikë të Epërme, në shkollën “Idriz Berani” Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë të ndryshëm. Dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Konsultimi publik filloi në orën 13; 30

Konsultimin e shpalli të hapur drejtori për buxhet dhe financa z.Ismet Aliu me ç ‘ rast prezantoi buxhetin e mundshëm dhe qarkoret buxhetore si dhe kufijtë konform qarkores buxhetore përfundimtare

Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
Bashkum Sahiti; A do ta rrisni numrin e fermerve të përkrahur me grante dhe mjete, mu nje pale pllugj smi keni dhene.	1.Po cdo vit po shkojmë duke e rritur buxhetin, nëse nuk dëmtohem nga regjistrimi i popullsisë kete vit
Bedri Smajli: Turiqecvi ka nevoje per ndriçim publik	2.Po e kemi paraparë do ta përfshijmë
Arton Osmani: Mbeturinat qe 5 jave nuk janë marrur	3. Do ta ngrisim kete çështje tek kompania rajonale sepse nuk eshte kompetence komplet e komunes
Agron Rama: Kemi nevoje per asfaltim te rrugicave te lagjeve	4.Po brenda vitit te ardhshëm do te kete veprime, do ta parashohim me buxhet nëse me kontratën aktuale nuk mundemi
Sami Osmani: Ndricim publik, nje mbrëmje smundemi me dal me be nje ecje	5. Po, do te përfshihet dhe përfundohet me buxhet te këtij viti

Komentet – Janë dhënë gjithsej 5 komente kompetetente, 4 do të përfshihen në buxhet

Tema	Zyra	Pjesëmarrës	Vendi Data	Komentet	1.Njoftimi 2.Lajmi 3.Procesverbali
Buxheti komunal	Zyra për Informim Zyra e Kuvendit	F 1 M 12 T 13	Klinë e Epërme	5 komente, 4 merren parasysh	Njoftimi » KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027 (rks-gov.net) Lajmi » Dëgjimi i tretë buxhetor është mbajtur në Turigec. (rks-gov.net) Procesverbali 1886_240918075716_001.pdf (rks-gov.net)

Ashtu siç është bërë edhe njoftimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailat e zyrtarëve. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik

Listat e nënshkrimeve të anëtarëve në takimet e mbajtura


Procesverbali

Njoftimi për mbajtjen e takimeve



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

No. 04/100/01-0045313/17
Datë: 17 09 2024



Komuna e Skenderajt
Skënderaj Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal

i diskutimit publik për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2025

Data: 22.08.2024

Ora: 13:30

Vendi: Turiqevc

Të pranishëm: Drejtori i drejtorisë së financave, drejtori i drejtorisë së urbanizmit, 13 persona qytetarë dhe nga Ojq

Përshkrim i përgjithshëm

Ky diskutim publik mbahet konform thirrjes publike nr.02-050/01-00388731/24 i datës 12.08.2024

Ismet Aliu-drejtor i drejtorisë për buxhet dhe financa: Përshëndetje, mirë se keni ardhur në takim të fundit për planifikimin e buxhetit komunal për vitin 2025. Ju përcjellë edhe përshëndetjet e kryetarit z.Nura. Konform legjislacionit dhe qarkores buxhetore dhe konform vullnetit të kryetarit që buxhetin ta vejmë nëpër vija sipas kërkesave tuaja edhe sipas kufijve fillestar dhe qarkores përfundimtare. Ky buxhet parasheh investime kapitale, shërbime dhe mallra, grante dhe subvencione e secila të ndara në kategori dhe kocke buxhetore

Pjesë nga diskutimi i qytetarëve

Bashkim Sahiti: Jam fermer, nuk më keni ndihmu asgjë, një palë ulla shi smi keni dhënë, i kam 300 copë dhi, cilësia e punë në fshatin tonë dhe bashkësi lokale është keq, një trotuar se keni shtrur për atë nënën e dëshmorit që kam bërë kërkesë, plus 300 metra rrugë nuk i keni krye dhe tualetet e shkollës janë shkatërru.

Sead Smajli: Përshëndetje, ura nuk ka mbrojtëse, kemi nevojë për ndriçim

Bedri Smajli: Përshëndetje, Unë jetoj jashtë vendit, këtu ka nevojë për ndriçim publik, dhe mbeturinat ka 5 javë që kompania nuk i ka marrur.

Agron Rama: Kemi nevojë për asfaltim të rrugës Haxhi Imeri dhe të mbikqyren punimet dhe të punohet më shpejtë

Sami Osmani: A pritet me pas ndriçim ne Turiqevc

Arton Osmani: E dimë që jemi komunë e vogël e nuk ka mjaftë buxhet, por punoni sa më mirë e kërkon nga qendra sa më shumë

Driton Mula: Eshtë punuar në kanalizimin Turiqevc e Vojnik, 950 metra ne vitin 2023, ujësjellësi në Burojë, kemi trajtu rrugë me zhavorr, do të trajtohet edhe rruga Haxhi Imeri, ne Turiqevc ndriçimi vjen brenda 1 muaji, jo vetëm në Turiqevc por dhe të ketë ndriçim dhe asfaltim rrugëve në edo fshat e edo lagje.


Ismet Aliu: Sa i përket buxhetit ne po presim që vetëm rënie të ketë, sepse me regjistrimin e fshatit të popullsisë jemi rreth 10 mije qytetare me pak ne komunë tonë, do të mundohemi që kërkesat tuaja të i adresojmë e përfshijmë ne buxhetin final. Ju falënderim

Procesmbajtësi Mirsad Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2025

Data: 22.08.2024, ora 13:30

Vendi: Shkolla "Abedin Rexha", Turiqec


Nr	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	Bejtarë Tasi	Burçje	Bilic
2	Zahira Tasi	Burçje	Z. Tasi
3	BEDRI SMAILI	TURIQEC	[Signature]
4	SAMI OSMANI	TURIQEC	[Signature]
5	VAKRI OSMAN	TURIQEC	[Signature]
6	Agim KAMAR	Turqec	[Signature]
7	Abdullah Tasi	Burçje	[Signature]
8	Arben Osmani	Turqec	[Signature]
9	Belma Tasi	Turqec	[Signature]
10	Enver Smaili	Turqec	[Signature]
11	Sullim Murat	Turqec	[Signature]
12	Blendi Osmani	Turqec	[Signature]
13	Xherat Durrani	Vepër i Qytetit	[Signature]
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Nr. 02-060/01-0523/24
Datë 12.07.2024



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

KALENDARI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2026, 2027

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt dhe Udhëzimin Administrativ të MAPL-së, Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për hartimin e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027

Procesi i hartimit të buxhetit është shumë i rëndësishëm për qytetarët e komunës së Skenderajt, të cilët nëpërmjet propozimeve dhe kërkesave për investime kapitale për vitin e ardhshëm, bëhen pjesë e vendimmarrjes në komunitetin e tyre.

Dëgjimet buxhetore do të mbahen me datat 21 dhe 22 gusht, sipas kalendarit të detajuar.

Në këto takime mund të marrin pjesë qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, lagjeve, organizatat e shoqërisë civile, komunitetet e ndryshme, grupe të caktuara të interesit, gratë, pensionistët, të rinjtë, klubet sportive, përfaqësues të komunitetit të biznesit, etj.

Nr.	Dëgjimi buxhetor me qytetarë për hartimin e buxhetit 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027	Dita/data e mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Vendi i mbajtjes	Ora
1.	Dëgjim buxhetor	E mërkurë, 21 gusht 2024	Elinë e Epërme, në Shkollën "Fetiz Berani"	13:30
2.	Dëgjim buxhetor	E mërkurë, 21 gusht 2024	Rurik, në Shkollën "Shotë Galca"	15:30
3.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Tirçec, në Shkollën "Abedin Rexha"	13:30
4.	Dëgjim buxhetor	E enjte, 22 gusht 2024	Salla e Kuvendit Komunal, Kati I	15:00

Komentet, kërkesat dhe sugjerimet lidhur me procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026, 2027, mund t'i dërgoni në email: smet.aliu@ark-s-gov.net dhe jeton.rushiti@ark-s-gov.net



Admir Lushtaku

Udhëheqës për Komunikim me Publikun